



Drejtoria e Arsimit
Nr.07-Zyrtarisht
28.01.2022

Në bazë të nenit 64, paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Deçan, shpallë këtë:


KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

Nr	Niveli, Shkolla	Pozita	Vend i Lirë /Me kohë të caktuar / Zëvendësim	Numri i pozitave
1	Shkolla Fillore Mesme e Ulët "Lan Selimi" në Lumbardh	Mësues Klase	Zëvendësim Lehonie	1
2	Shkolla Fillore Mesme e Ulët "Dëshmorët e Kombi" në Strellc i Ulët (8 orë); Shkolla Fillore Mesme e Ulët "Isa Boletini" në Isniq (4 orë); Shkolla Fillore Mesme e Ulët "Faik Konica" në Ratish (8 orë)	Mësimdhënës i/e Edukatë Fizike (20 orë) - <u>Rishpallje</u>	Zëvendësim Lehonie	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit;
- Rezumeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta - kopje);
- Diploma e kualifikimit e noterizuar;
- Trajnime (nëse ka);
- Vërtetimin për përvojën e punës (nëse ka);
- Certifikata që nuk jeni nën hetim;
- Certifikata e lindjes;
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHT.



II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar, ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm nr.05/2021.

Kushtet dhe Kualifikimi – Mësues Klase:

- Fakultetit i Edukimi – programi fillor;
- Fakulteti i Mësuesisë.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e Edukatës Fizike:

1. Niveli master arsimor (300 ECTS);
2. Sistemi katërvjeçar;
3. Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

III. Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-37 datë 29 gusht 2011, në nenin 16 paragrafi 5 thotë: "Vetëm bartësit (publik) të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që qojnë në kualifikimin e një mësimdhënësi, për tu punësuar në një shkollë".

IV. Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

V. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

VI. Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente(jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

VII. Për intervistë do të ftohën vetëm kandidatët, të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

VIII. Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje, (kualifikimet universitare duhet të jenë të noterizuara), dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistës.

Formularin i Aplikimit për Punësime shkarko këtu:

<https://kk.rks-gov.net/decan/wp-content/uploads/sites/9/2021/01/Formulari-Aplikimi-Per-Punesim-07AR.pdf>

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në faqen zyrtare të komunës, duke filluar nga data e publikimit më: 28.01.2022 më datën: 11.02.2022

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes zyrës së DKA-së Nr. 52 , në objektin e Komunës së Deçanit.

Drejtori

Dr.Sc. Bekim Vishaj

